

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap – KŽ – 351/2010
25 maj 2011
Prishtinë

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Martti Harsia si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues, dhe gjyqtareve të Gjykatës Supreme Emine Mustafa dhe Marije Ademi si anëtare të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore e EULEX-it Noora Aarnio si procesmbajtëse

Në lëndën penale kundër të pandehurit **Shefqet Musliu**, i dënuar nga Gjykata e Qarkut në Gjilan për dy Rrëmbime në kundërshtim të Nenit 64 paragrafëve 1, 2 dhe 4 të Ligjit Penal të Serbisë [LPS] lidhur me Nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë [KPRSFJ], detyrim në tentativë të dëshmitarit në kundërshtim të Nenit 180 të LPS-së lidhur me Nenet 19 dhe 22 të KPRSFJ -së dhe rrëmbim kundërshtim të Nenit 64 paragrafëve 1, dhe 2 të LPS-së lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ -së,

dhe të pandehurit **Besim Tahiri**, i dënuar nga Gjykata e Qarkut në Gjilan për dy rrëmbime në kundërshtim të Nenit 64 paragrafëve 1, 2 dhe 4 të LPS-së lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ -së,

Pas mbajtjes së seancës së hapur për publik më 24 maj 2011, në prani të Prokurorit të Shtetit të përfaqësuar nga Prokurorja Laura Pula, Avokatët mbrojtës Masar Morina dhe Nikë Shala, më 25 maj 2011 shpall publikisht këtë

AKTVENDIM

Shefqet Musliu, emri i të atit _____, emri i së ëmës _____, i lindur në _____, me banim në _____, i lindur më _____, Shqiptar i Kosovës, mekanik, _____, ka të kryera 8 vjet shkollë, tani në vuajtje të dënimit në Burgun e Dubravës,

Ankesat e paraqitura në emër të të pandehurit **Shefqet Musliu** kundër Aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan në lëndën P.nr. 181/2007, të datës 5 tetor 2010, pranohen. Aktgjyqimi anulohet dhe lënda kthehet në Gjykatën e Qarkut në Gjilan për rigjykim.

Paraburgimi kundër Musliut ndërpritet.

Besim Tahiri, me nofkën Cecen, emri i të atit _____, emri i nënës _____, vendi i lindjes _____, banor i _____, data e lindjes _____, Shqiptar i Kosovës, bujk, _____, ka të kryer shkollën e mesme, _____, nuk ka procedurë tjetër penale në zhvillim e sipër kundër tij,

Ankesa e paraqitur në emër të pandehurit **Besim Tahiri** kundër aktgjykimit të Gjykatës të Qarkut të Gjilanit në lëndën P.nr. 181/2007, të datës 5 tetor 2010 pranohet. Aktgjykimi anulohet dhe lënda kthehet në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit për rigjykim.

ARSYETIMI

I HISTORIA E PROCEDURËS

Hetimet penale kanë filluar kundër **Besim Tahiri** më 20 qershor 2003 me vendim për fillimin e hetimeve kundër tij, dhe kundër **Shefqet Musliut** më 9 korrik 2003

Më 9 dhjetor 2003 Prokurori Publik Ndërkombëtar ngriti një aktakuzë kundër **Shefqet Musliut** dhe **Besim Tahirit**.

Aktakuza u ndryshua më 21 janar 2004. Në aktakuzën e ndryshuar i pandehuri **Shefqet Musliu** ishte akuzuar për dy Rrëmbime në kundërshtim të Nenit 64 paragrafëve 1, 2 dhe 4 të LPS-së lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ-së, detyrim në tentativë të dëshmitarit në kundërshtim të Nenit 180 të LPS-së lidhur me Nenin 19 dhe 22 të KPRSFJ -së dhe rrëmbim në kundërshtim të Nenit 64 paragrafëve 1 dhe 2 të LPS-së lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ -së, mbajtje në posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 8.2 dhe 8.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/7, rrëmbim në kundërshtim të Nenit 64 paragrafëve 1 dhe 2 të LPS-së lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ-së, mbajtje në posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 8.2 dhe 8.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/7, rrëmbim në kundërshtim të Nenit 64 paragrafëve 1 dhe 2 të LPS-së lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ-së dhe bashkim kriminal në kundërshtim të Nenit 227 të LPS-së. I pandehuri **Besim Tahiri** ishte akuzuar për dy rrëmbime në kundërshtim të Nenit 64 paragrafëve 1, 2 dhe 4 të LPS-së lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ-së, rrëmbim në kundërshtim të Nenit 64 paragrafëve 1 dhe 2 të LPS-së lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ -së, mbajtje në posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 8.2 dhe 8.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/7, dhe bashkim kriminal në kundërshtim të Nenit 227 të LPS-së.

Shqyrtimi i parë gjyqësor u mbajt prej muajit shkurt deri në qershor të vitit 2004 në Gjykatën e Qarkut në Gjilan. Me aktgjykimin e shpallur më 25 qershor 2004 Gjykata e Qarkut në Gjilan shpalli të pandehurin **Shefqet Musliu** fajtor për katër akuza të rrëmbimit dhe një akuzë të detyrimit në tentativë të dëshmitarit. Ai u lirua nga dy akuza

të mbajtjes në posedim të paautorizuar të armëve dhe nga akuza e bashkimit kriminal. Ai u dënua me një dënim unik me 12 vjet burgim. I pandehuri **Besim Tahiri** u shpall fajtor për tri akuza të rrëmbimit. Ai u lirua nga dy akuza të mbajtjes në posedim të paautorizuar të armëve dhe nga akuza e bashkimit kriminal.

Aktgjykimi është ankimuar nga dy të pandehurit. Duke vendosur lidhur me ankesën, më 27 mars 2007 Gjykata Supreme e Kosovës pjesërisht ka pranuar aktgjykimin. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan pjesërisht është anuluar dhe lënda është kthyer në Gjykatën e Qarkut për rigjykim në lidhje me rrëmbimin e dëshmitarit FY dhe dënimin unik. Më 10 mars 2010 Gjykata Supreme ka korrigjuar një gabim material të dukshëm në aktgjykimin e saj të mëparshëm.

Më 1 tetor 2010, Kryeprokurori i EULEX-it nga Zyra e Prokurorisë së Qarkut e Republikës së Kosovës ka vendosur që t'i tërheq akuzat kundër Shefqet Musliut dhe Besim Tahirit në lidhje me pikën e rrëmbimit të dëshmitarit FY.

Gjykata e Qarkut në Gjilan ka mbajtur një seancë më 1 shtator dhe 5 tetor 2010, në prani të prokurorit, të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës. Më 5 tetor 2010, Gjykata e Qarkut në Gjilan ka shpallur aktgjykimin e saj duke e refuzuar akuzën për rrëmbim të dëshmitarit FY. Gjykata ka dënuar Shefqet Musliu me dënim unik prej dhjetë viteve dhe gjashtë muajve burgim për veprat penale rrëmbim të dëshmitarëve 3,4 dhe AK dhe detyrim në tentativë të dëshmitarit 1, kurse i pandehuri Besim Tahiri është dënuar me dënim unik prej gjashtë viteve dhe nëntë muajve burgim për veprat penale rrëmbim të dëshmitarëve 3 dhe 4.

Më 20 tetor 2010 aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit Shefqet Musliu.

Më 15 tetor 2010 aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit Besim Tahirit, dhe përsëri i është dorëzuar më 29 tetor 2010.

Më 15 tetor 2010, avokati mbrojtës Masar Morina ka paraqitur ankesë në emër të dy të pandehurve kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan.

Më 2 nëntor 2010, avokati mbrojtës Nikë Shala ka paraqitur ankesë në emër të pandehurit Shefqet Musliut kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan.

Më 4 nëntor 2010, Prokurori Publik i Qarkut ka paraqitur përgjigje ndaj ankesave të të pandehurve, dhe mendimi dhe propozimi i Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPShK) është pranuar nga Gjykata Supreme më 8 dhjetor 2010

II ANKESA E MBROJTJES DHE PËRGJIGJA E PROKURORISË

Ankesa e avokatit Masar Morina kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë në disa baza. Ai pohon se Aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të procedurës

penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të kodit penal dhe kërkon që dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve të ndryshohet. Avokati mbrojtës propozon që dënimi të zbutet.

Arsyet e paraqitura në ankesë janë përmbledhur si në vijim:

- Së pari, dispozitat e ligjit të aplikueshëm janë shkelur sepse në aktakuzë sa i përket rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4, akuza është për një vepër penale rrëmbim i dy personave, por të pandehurit janë shpallur fajtorë dhe dënuar për dy vepra penale të rrëmbimit të një personi.
- Së dyti, dënimi unik për Musliun e tejkalon dënimin e përcaktuar me ligj. Dënimi unik nuk mund të jetë më i lartë se dënimi maksimal për veprën penale e që në këtë lëndë është 10 vite.
- Si arsye e tretë dhe përfundimtare për ankesë mbrojtja pohon se Musliu ka qenë në paraburgim nga marsi i vitit 2003.

Ankesa e avokatit Nikë Shala për Musliun kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket vendimit mbi dënimin. Avokati mbrojtës propozon që dënimi të jetë nën minimumin e përcaktuar me ligj.

Arsyet e paraqitura në ankesë janë përmbledhur si në vijim:

- Së pari, gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar dhe analizuar në mënyrë të duhur të gjitha rrethanat të cilat do të mund të ndikojnë në lartësinë e dënimin.
- Së dyti, Musliu nuk ka as dënime të mëparshme dhe as procedura të tjera penale të zhvilluara ndaj tij. Ai është një ish-komandant i UÇPMB, i martuar, askush në familjen e tij nuk është i punësuar, gëzon respekt në mjedisin ku jeton dhe punon.
- Së treti, ai është paraburgosur që nga 07.07.2003 - mbi 7 vjet ose 2 / 3 e dënimin të shqiptuar nga Gjykata e Qarkut, por për shkak të procedurave në vazhdim nuk është liruar me kusht siç parashihet me ligj. Prandaj të drejtat e tij janë shkelur. Ai ka pasur sjellje të mirë në burg.
- Si arsye e katërt dhe e fundit për ankesë mbrojtja pretendon se qëllimi i dënimin është arritur për shkak të viteve të kaluara në paraburgim.

Prokurorja Publike e Qarkut e EULEX-it në përgjigjen e saj thekson se ankesat janë të pabazuara. Prokuroria argumenton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Avokati mbrojtës nuk e justifikon asnjë nga arsyet me prova përkatëse.

Prokurori i Shtetit në mendim e tij pohon se ankesat e të pandehurve janë të pabazuara dhe në këtë mënyrë i propozon Gjykatës Supreme që t'i refuzoj ankesat dhe ta vërtetoj aktgjykimi e shkallës së parë. Prokurori i shtetit pohon se çështja e paraburgimit është

konfirmuar nga Gjykata Supreme e Kosovës. Konstatimi i gjykatës së shkallës së parë është i duhur dhe i bazuar në ligj. Gjykata në mënyrë të duhur dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike. Gjykata ka përshkruar në detaje veprimet inkriminuese. Gjithashtu, ligji penal është zbatuar në mënyrë të duhur kur janë cilësuar veprimet e të pandehurve. Gjithashtu vendimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me dënimin është i bazuar në ligj dhe është i drejtë. Avokati mbrojtës nuk ka konstatuar ndonjë rrethanë lehtësuese.

III GJETJET E GJYKATËS

A. Pranueshmëria e ankesës

Gjykata Supreme konstaton se ankesat e parashtruara në emër të të pandehurit Musliu janë të parashtruara me kohë dhe të pranueshme sa i përket refuzimit të akuzave të rrëmbimit të dëshmitarit FY dhe të përcaktimit të dënimit unik. Aktgjykimi i ankimuar i është dorëzuar të pandehurit Musliu me 20 tetor 2010. Ankesa e avokatit mbrojtës Morina ishte parashtruar në Gjykatën e Qarkut në Gjilan me 15 tetor 2010 dhe ankesa e avokatit mbrojtës Shala me 2 nëntor 2010, kështu që brenda afatit të 15 ditëve siç parashihet në nenin 359 të LPP-së. Ankesat janë parashtruar nga avokatët mbrojtës, personat e autorizuar.

Aktgjykimi i ankimuar i është dorëzuar të pandehurit Tahiri me 15 tetor 2010 dhe përsëri me 29 tetor 2010 dhe ankesa e mbrojtjes është parashtruar në Gjykatën e Qarkut në Gjilan me 15 tetor 2010, kështu që brenda afatit të 15 ditëve siç parashihet në nenin 359 të LPP-së. Ankesa është parashtruar nga avokati mbrojtës, person i autorizuar.

Gjykata Supreme konstaton se ankesat janë të bazuara. Kolegji tani do të vlerësoj secilin argument të ngritur në ankesa.

B. Fusha e shqyrtimit ankimor

Në aktakuzën e ndryshuar të datës 9 dhjetor 2003 të dytë Shefqet Musliu dhe Besim Tahiri me individët tjerë janë akuzuar me rrëmbimin e dy personave në datën e pacaktuar në shtator të vitit 2000 në Dobërçan, Gjilan me qëllim të zhvatjes (rrëmbimit) të hollave nga ata. Prandaj, të pandehurit kanë kryer dy (2) pika të padisë (akuzës) së rrëmbimit.

Nga struktura e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan më 25 qershor 2004 është e paqartë nëse gjykata ka ndryshuar cilësimin e prokurorit të rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4 si dy vepra penale. Pjesa dënuese e aktgjykimit në fjalë është e shkruar në mënyrë pak të dykuptimshëm ashtu që lejon interpretimin se rrëmbimi i dëshmitarit 3 dhe dëshmitarit 4 janë konsideruar vepra të veçanta penale. Gjykata Supreme thekson se ka

vërtetuar "...aktgjykimin që ka të bëj me dënimin prej tetë (8) vjetëve sa i përket secilës vepër të rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4..."¹. Nga kjo është e qartë se Gjykata Supreme e ka interpretuar rrëmbimin e dëshmitarëve 3 dhe 4 si dy vepra të veçanta penale. Gjykata Supreme gjithashtu ka miratuar vlerësimin e Gjykatës së Qarkut për dënimin dhe ka vërtetuar se tetë vite burgim të jetë dënim i drejtë për secilën prej rrëmbimeve.

Prandaj, Gjykata Supreme si përgjigje në ankesat thekson se çështja e atributimit të fajësisë së të pandehurve në rrëmbimin e dëshmitarëve 3 dhe 4 tashmë është përcaktuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, prandaj nuk mund të ri-definohet. E njëjta aplikohet në dënimin për secilën vepër penale. Prandaj, fusha e shqyrtimit ankimor është përcaktimi i dënimit unik.

C. Ligji në fuqi

Gjykata Supreme pajtohet me vlerësimin e Gjykatës së Qarkut për zbatimin e ligjit në përcaktimin e dënimit unik.

Sipas nenit 48 paragrafit 2 nën-paragrafit 3 të LP të RFSJ-së gjykata do të shqiptojë dënim unik sipas rregullit vijues: nëse gjykata ka vendosur për dënimet e burgimit për vepra penale të kombinuara, dënimi unik do të përbëjë dënimin më të rreptë të vlerësuar, por që dënimi unik nuk mund të jetë në tërësi njësoj i lartë sa të gjitha dënimet e dhëna, dhe nuk mund të tejkalojë periudhën prej 15 viteve burgim. Gjykata Supreme vëren se vepra penale e rrëmbimit sipas nenit 64 paragrafit 4 të ligjit parasheh dënim prej një deri në dhjetë vjet burgim. Kështu që maksimumi i dënimit unik është 15 vjet.

D. Vërtetimi i duhur i gjendjes faktike

Kolegji rikujton se për fajësinë e të pandehurit Musliu për dy pika të rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4, përpjekja për detyrim të dëshmitarit 1 si edhe rrëmbimi i AK si edhe fajësia e të pandehurit Tahiri për dy pika të rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4, është vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin e datës 27 mars 2007 dhe korrigjimi i tij i datës 10 mars 2010.

Me 27 mars 2007, Gjykata Supreme thekson se "Kjo gjykatë e bën në mënyrë perfekt të qartë që sa i përket pikave 1, 2 dhe 4, pas vlerësimit të kujdesshëm dhe të plotë të shkresave të lëndës, duke përfshirë të dyja provat dokumentare dhe dëshmitë e paraqitura nga të dyja palët, është e kënaqur që gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktet vendimtare të lëndës në mënyrë të plotë dhe të saktë." Pika 1 i referohet veprës së rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4, pika 2 përpjekjes për detyrim dhe pika 4 rrëmbimit të

¹ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 27 mars 2007, faqja 3 e versionit në gjuhën angleze

AK-së. Prandaj, elementet duke përfshirë rolin e të pandehurit, sjelljen e tij materiale dhe të qëllimit të tij subjektiv, janë shprehur në mënyrë shumë të qartë dhe pa dykuptimësi kështu që i pandehuri dhe të gjithë personat e interesuar mund të kuptojnë akuzat me të cilat i pandehuri është shpallur fajtor.

Gjithashtu, dënimet individuale të secilës prej veprave penale janë vërtetuar në aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme.

Për më tepër, sipas nenit 348 paragrafit 2 të LPP-së nëse akuza përfshin disa vepra penale, aktgjykimi do të deklaroj për secilën prej tyre nëse akuza është refuzuar, nëse i pandehuri është liruar nga akuza, ose i shpallur fajtor. Neni 351 më tutje specifikon përmbajtjen e shpalljes së aktgjykimit duke e shpallur të pandehurin fajtor.

Megjithatë referimi i thjeshtë për aktgjykimin e lartë përmendur të Gjykatës Supreme në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut mbi dënimin unik nuk është i mjaftueshëm sepse dispozitivi i dënimit të ankimuar është i pakuptueshëm kur lexohet ndaras nga aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme.

Për më tepër aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut nuk përmban një përshkrim të detajuar të akuzës penale të refuzuar të rrëmbimit të dëshmitarit FY. Pa këtë përshkrim është e pamundur për të ditur elementet e veprës penale duke përfshirë kohën dhe vendin e veprës, rolin e të pandehurit, sjelljen e tij materiale dhe qëllimin e tij subjektiv, kështu që të kuptoj akuzat me të cilat është refuzuar. Gjykata Supreme beson se si rezultati i kësaj mangësie dispozitivi është i pakuptueshëm. Mangësia, prandaj, përmban një shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sikurse është parashikuar në nenin 364 paragrafi 1 pika 11 e Ligjit të Procedurës penale [LPP].

E. Dënimi

Përfundimisht, sa i përket dënimit, Gjykata Supreme pohon që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë ka shpjeguar dispozitat e ligjit të aplikueshëm që kanë të bëjnë me shqiptimin e dënimit unik. Megjithatë, gjykata e shkallës së parë nuk ka shpjeguar në mënyrë të qartë se si i ka kombinuar dënimet individuale dhe përfundimisht vendosi të shqiptoj dënimin unik të ankimuar.

F. Konkluzion

Pasi që Gjykata Supreme vlerëson se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale është vendosur sikur në dispozitiv.

Më datë 25 maj 2011.
Ap.-Kž. nr. 351/2010

I përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë e autorizuar.

Kryetari i kolegjit

Martti Harsia

Anëtare e kolegjit

Emine Mustafa

Procesmbajtëse

Noora Aarnio

Anëtare e kolegjit

Marije Ademi

